

## Vizita e punës në ZAP Kosovë në kuadër të auditimit paralel ndërmjet dy institucioneve

Në datat 20.02.2023-21.02.2023, u zhvillua një vizitë pune në Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, në kuadër të bashkëpunimit me temë “Auditimet Paralele të TI-së KLSH-ZKA”, ku pjesëmarrës ishin anëtarët e grupit të auditimit, Elira Cukalla, Rodjan Alimerkaj dhe Megi Peza.

Gjatë ditës së parë, diskutimet u zhvilluan mbi sfidat e këtij auditimi si dhe gjetjet e auditimit nga grupi auditues i ZKA-së dhe KLSH-së, përkatësisht për ujësjellësin e Prishtinës dhe të Tiranës.



Grupet kanë zhvilluar auditim me temë “Sistemet e Teknologjisë së Informacionit”, me pak ndryshime në drejtimet e auditimit. Përzgjedhja e temës dhe subjektit me aktivitet të njëjtë, krijoi mundësinë që diskutimet të ishin të fokusuara dhe profesionalisht të kuptueshme nga të gjithë audituesit dhe gjatë gjithë fazave të këtij bashkëpunimi.

Ngjashmëria e problematikave të konstatuara në të dy auditimet ishte shumë e lartë, çfarë tregon se teknologjia e informacionit është zhvilluar me hapa të ngadaltë dhe shoqëruar me problematika të përafërta në të dy institucionet.

Ditën e dytë të takimit, në datën 21.02.2023, grupi i auditimit të KLSH-së, zhvilloi një vizitë në ujësjellësin “KRU Prishtina” Sh.A, si dhe impiantin e trajtimit të ujit në Shkaba, si një nga investimet më bashkëkohore në rajon në këtë drejtim, për t’u prezantuar nga afër me funksionimin, sistemet dhe proceset teknologjike të trajtimit të ujit.



Në këtë takim, vëmendja u vendos tek teknologjia e informacionit dhe hapat që nevojitet të marrin insitucionet, për të avancuar në drejtim të saj, gjithmonë në mbështetje të objektivave institucionalë.

Çështjet që kanë më shumë ndjeshmëri dhe të gjithë dakordësohen janë masat që duhet të ndërmeren për dixhitalizimin e proçeseve, sigurinë dhe kontrollin e të dhënave si dhe rritjen e efikasitetit nga përdorimi i teknologjisë së informacionit.

Në fund të ditës së dytë të takimit, në prani të Drejtorit të auditimit të Teknologjisë së Informacionit të ZKA-së, u diskutuan hapat që vijnë për auditimet e kryera nga secili institucion. Secili grup auditimi do të gjenerojë një raport auditimi në përputhje me detyrimet dhe afatet ligjore dhe në përfundim të evadimit, përafërsisht në maj të vitit 2023, do të hartohet një përmbledhje e përbashkët e problematikave të ngjashme të evidentuara në drejtim të teknologjisë së informacionit në shoqëritë e ujësjellës kanalizime, Tiranë dhe Prishtinë.